



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D / DPKI
Nr. Prot. 01-1015/2012
Data 13.03.2012
Broj stranica 02
Nr. pages
PRISHTINE

DATË/A:	13.03.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-
PËR/ZA/TO:	z. Ekrem Rexha Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Komunën e Prishtinës
CC:	z. Isa Mustafa Kryetar i Komunës Prishtinës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin “Hartimi i planit zhvillimor Komunal”

I nderuari z. Rexha

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin (“Hartimi i planit Zhvillimor Komunal” me numër prokurimit 616-12-014-221 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Komuna Prishtinës t’i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetimin, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit për prokurimin publik të Kosovës nr. 04-L/042.

Arsyetim

Zyra e prokurimit në Komunën e Prishtinës , si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit “Shërbime” të procedurës së hapur me nr. të prokurimit 616-12-014-221 me titull “Hartimi planit zhvillimor Komunal” në Prishtinë , në Pjesën, Seksioni II, Fleta e të dhënave të tenderit te neni 9.2 i Dosjes së tenderit te Kërkesat mbi mundësit teknike dhe/ose profesionale Dokumentet e Kërkuara – ka kërkuar , veç tjerash, Specifikimi i kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të personit ose

personave që drejtpërdrejtë është ose janë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve përkatëse të njëjta , te ngjashëm ose shërbime intelektuale.

Zyra e prokurimit këto kërkesa i ka shpalosur edhe njëherë duke i zbërthyer në kuadër të Aneksit 6 Kriteret për dhënien e kontratës te tenderi ekonomikisht më i favorshëm, ku ka paraparë: “ Përvoja profesionale e menaxherit të projektit- minimum 5 vite përvoja pas diplomimit nominale 15 vjet pesha e këtij kriteri është 10 %, ndërsa “përgatitja profesionale e stafit dhe përvoja përgatitja shkollore superiore (për se paku tre anëtar) dhe se paku për tri vite përvoja pas diplomimit secili prej tyre nominale pese vite përvoja ”pesha e këtij nën kriteri është 7 % të poentimit.

Me aktin e këtillë të përsëritjes (dyfishimit) të kërkesave të njëjta të tenderit, Autoriteti Kontraktues ka shkelur Ligjin nr.04/L-042 të Prokurimit Publik konkretisht këto dispozita:

- Dispozitën e nenit 52.4 të LPP-së 04/L-042 .

Me respekt!

